

KIRFN Interpretimi 5

Të Drejtat për Interesat që Rrjedhin nga Fondet e Nxjerrjes nga Përdorimi, Restaurimi dhe Rehabilitimi Mjedisor

Referencat

- SNRF 9 *Instrumentet Financiarë*
- SNRF 10 *Pasqyra Financiare të Konsoliduara*
- SNRF 11 *Marrëveshjet e Përbashkëta*
- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 28 *Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta*
- SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara*

Konteksti

- 1 Qëllimi i fondeve të nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe rehabilitimi mjedisor, që këtu e më tutje do t'i referohemi si 'fonde të nxjerrjes nga përdorimi' ose 'fonde', është të veçojë aktive për të financuar një pjesë ose të gjitha kostot e nxjerrjes nga përdorimi të uzinës (të tillë si një reaktor bërthamor) ose të ndonjë pajisjeje (të tilla si makina), ose ndërmarrja e rehabilitimit mjedisor (të tillë si korrigjimi i ndotjes së ujit ose përtëritja e një terreni të minuar), të cilave së bashku u referohemi si 'nxjerrje nga përdorimi'.
- 2 Kontributet për këto fonde mund të jenë vullnetare ose të kërkuara nga ligji. Fondet mund të kenë njërën nga strukturat në vijim:
 - (a) fonde që krijohen nga një kontribues i vetëm për të financuar detyrimet e tij që rrjedhin nga dalja jashtë përdorimit, për një vend të caktuar ose për një numër vendesh të shpërndara nga këndvështrimi gjeografik.
 - (b) fonde që krijohen nga shumë kontribues për të financuar detyrimet e tyre individuale ose të përbashkëta që rrjedhin nga dalja jashtë përdorimit, në të cilat kontribuesit kanë të drejtën e rimbursimit për shpenzimet e lidhura me nxjerrjen nga përdorimi në madhësinë e kontributeve të tyre plus çdo fitim aktual mbi këto kontribute minus pjesën e tyre të kostove për administrimin e këtyre fondeve. Kontribuesit mund të kenë detyrimin për të derdhur kontribute shtesë për shembull në rast të falimentimit të një kontribuesi tjetër.
 - (c) fonde që krijohen nga shumë kontribues për të financuar detyrimet e tyre individuale ose të përbashkëta që rrjedhin nga dalja jashtë përdorimit, në të cilat niveli I kërkuar I kontributit bazohet në aktivitetin e tyre aktual si kontribues dhe përfitimi I marrë nga ky kontribues bazohet në aktivitetin e tij të shkuar. Në të tilla raste ekziston mundësia e një ngatërrimi në shumën e kontributeve të derdhura nga një kontribues (bazuar në aktivitetin aktual) dhe vlerën e realizueshme nga fondi (bazuar në aktivitetin e shkuar).
- 3 Zakonisht fonde të tilla kanë tiparet në vijim:
 - (a) fondi administrohet veçmas nga të besuar të pavarur.
 - (b) njësitë ekonomike (kontribuesit) derdhen kontribute në fond, të cilat investohen në një gamë të gjerë aktivesh që mund të përfshijnë si investime në borxh edhe në kapital neto dhe janë të gatshme të mbulojnë kostot e nxjerrjes nga përdorimi të kontribuesve. Të besuarit përcaktojnë si investohen kontributet, brenda kufizimeve të vendosura nga dokumentet qeverisës të fondit dhe çdo legjislacion apo rregulla të tjera të zbatueshme.
 - (c) kontribuesit mbajnë (kanë) detyrimin për të paguar kostot e nxjerrjes nga përdorimi. Megjithatë kontribuesit janë në gjendje të marrin rimbursimin e kostove të nxjerrjes nga përdorimi nga fondi deri në pakësimin e kostove të nxjerrjes nga përdorimi dhe pjesës së kontribuesit mbi aktivet e fondit.
 - (d) kontribuesit mund të kenë hyrje të kufizuar ose aspak hyrje ndaj ndonjë teprice të aktiveve të fondit gjatë përdorimit të tyre për të plotësuar kostot e ligjshme të nxjerrjes nga përdorimi.

Objekti

- 4 Ky Interpretim zbatohet për përfshirjen në pasqyrat financiare të kontribuesit të interesave që vijnë nga fondet e nxjerrjes nga përdorimi të cilat kanë të dy tiparet në vijim:
- (a) aktivet administrohen veçmas (ose duke u mbajtur në një njësi ekonomike ligjore të veçantë ose si aktive të veçuara brenda një njësie ekonomike tjetër); dhe
 - (b) e drejta e kontribuesit për të disponuar aktivet është e kufizuar.
- 5 Interesi i mbetur në një fond që shkon përtej të drejtës për rimbursim, i tillë si një e drejtë kontraktuale për shpërndarje pasi të ketë përfunduar e gjithë nxjerrja nga përdorimi ose mbi mbylljen e fondit mund të jetë një instrument kapitali neto brenda objektit të SNRF 9 dhe nuk është objekt i këtij Interpretimi.

Çështjet

- 6 Çështjet e prekura nga ky Interpretim janë:
- (a) si duhet të trajtojë një kontribues interesat e tij në një fond?
 - (b) nëse një kontribues ka një detyrim për të derdhur kontribute shtesë, për shembull, në rast falimentimi të një kontribuesi tjetër, si duhet të trajtohet ky detyrim?

Konsensusi

Kontabiliteti për interesin në një fond

- 7 Kontribuesi do të njohë detyrimin e tij për të paguar kostot e nxjerrjes nga përdorimi si një detyrim dhe të njohë interesin e tij në fond veçmas me përjashtim të rastit kur kontribuesi nuk është i detyruar të paguajë kostot e nxjerrjes nga përdorimi edhe nëse fondi nuk arrin të paguajë.
- 8 Kontribuesi do të përcaktojë nëse ai ka kontrollin, kontrollin e përbashkët apo influencë të konsiderueshme mbi fondin duke ju referuar SNRF 10, SNRF 11 dhe SNK 28. Nëse po kontribuesi do të trajtojë interesat e tij në fond në përputhje me këto Standarde.
- 9 Nëse një kontribues nuk ka kontroll, kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi fondin, atëherë ai do të njohë të drejtën që të rimburohet nga fondi në përputhje me SNK 37. Ky rimbursim do të matet me më të voglën e:
- (a) shumës së njohur për detyrimin për nxjerrje nga përdorimi; dhe
 - (b) pjesës së kontribuesit mbi vlerën e drejtë të aktiveve neto të fondit që u takojnë kontribuesve.
- Ndryshimet në vlerën kontabël (neto) të së drejtës për të marrë rimbursim, të ndryshëm nga kontributet dhe pagesat nga fondi do të njihen në fitimin ose humbjen e periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

Kontabiliteti për detyrimet për të derdhur kontribute shtesë

- 10 Nëse një kontribues ka një detyrim për të derdhur potencialisht kontribute shtesë, për shembull, në rast të falimentimit të një kontribuesi tjetër ose nëse vlera e investimit në aktive të mbajtur nga fondi bie në një madhësi të tillë që ato janë të pamjaftueshëm për të plotësuar detyrimet për rimbursim të fondit, ky detyrim është një detyrim i kushtëzuar që është brenda objektit të SNK 37. Kontribuesi do të njohë një detyrim vetëm nëse ka mundësi që të derdhen kontribute shtesë.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 11 Një kontribues do të japë informacion shpjegues për natyrën e interesave të tij në një fond dhe ndonjë kufizim për disponimin e aktiveve në fond.
- 12 Nëse një kontribues ka një detyrim për të derdhur potencialisht kontribute shtesë që nuk është njohur si detyrim (shih paragrafin 10), ai duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 86 i SNK 37.

- 13 Nëse një kontribues trajton interesat e tij në fond në përputhje me paragrafin 9, ai do të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 85(c) i SNK 37.

Data e hyrjes në fuqi

- 14 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 Janar 2006 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për një periudhë që fillon më parë se 1 Janar 2006, duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 14A [Fshirë]
- 14B SNRF 10 dhe SNRF 11, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 8 dhe 9. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.
- 14C [Fshirë]
- 14D SNRF 9, i publikuar në Korrik 2014, ka ndryshuar paragrafin 5 dhe ka fshirë paragrafët 14A dhe 14C. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.

Periudha kalimtare

- 15 Ndryshimet në politikat kontabël do të trajtohen në përputhje me kërkesat e SNK 8.

